

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“BLINK Terminal” SH.P.K

Sot, më datë 21.06. 2019 (dymije e nenetembedhjete), ortaket:

1. “Divinus Investments” shpk, shoqeri me pergjegjesi te kufizuara, me NIPT L81707021H, me seli, Bulevardi Deshmoret e Kombit, Kullat Binjake, Kulla nr. 2, Kati 5, Tirane, e perfaqesuar nga z. Florid Ismailaj, Lindur ne Fier, banues në adresen: Rruga “Mustafa Xhabrahimi”, Banesa nr. 7, Tirane, shtetas shqiptar, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. ID J60304043E
2. Ardit Sota, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.01.1992, lindur në Vlore, (Shqiperi), dhe banues në adresen: Rruga “Liman Kaba”, Pallati 1, Ap. 10, Tirane, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. ID J20104041B

vendosen te themelojne nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar dhe ne perputhje me dispozitat vijuese.

NENI 1
Themelimi

Emri i shoqerise eshte **“BLINK Terminal” Shpk**. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri **“BLINK Terminal” Shpk**, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

NENI 2
Qëllimi i krijimit të Shoqërisë

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit të internet kafe. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter tregetar dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3
Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“BLINK Terminal” Shpk**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.



NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë është: aktivitet Internet Kafe. Shoqëria kryen cdo lloj veprimtarie të dobishme për arritjen e objektivave të saj, duke përfshirë edhe veprimtari tjeter ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të shoqërisë e që nuk bie në ndesh me legjislacionin Shqiptar në fuqi. Shoqëria do të kryejë cdo aktivitet në funksion të objektit kryesor të saj.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Shoqëria e ka selinë në Tiranë me adresë: Rruga "Rreshit Petrela", pranë Postës Shqiptare ZP 5/1, njesia nr. 9. Tiranë, Shqipëri.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortaket

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) lek, i ndarë në 2 (dy) kuota me vlerë nominale të një kuote prej 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) lek dhe 49.000 (dyzetë e nente mijë) lek.

Ortaket themelues të Shoqërisë Tregtare "**BLINK Terminal**" shpk zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- "Divinus Investments" shpk, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me NIPT L81707021H, me seli, Bulevardi "Dëshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla nr. 2, Kati 5, Tiranë, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 51.000 (pesëdhjetë e një mijë) Lek, duke përfaqësuar 51% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Ardit Sota, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.01.1992, lindur në Vlorë, (Shqipëri), dhe banues në adresën: Rruga "Liman Kaba", Pallati 1, Ap. 10, Tiranë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. ID J20104041B, zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme 49.000 (dyzetë e nente mijë) Lek, duke përfaqësuar 49% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortaket me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësitë e ortakeve shtrihen deri në shumën e kontributeve të tij në kapitalin themeltar



NENI 7
Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:
Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 8
Administratori

Shoqëria administrohet nga Administratori i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje.

Administratori i shoqërisë do të jetë z. Florid Ismailaj, i datëlindjes 04.03.1996, lindur në Fier, banues në adresën: Rruga "Mustafa Xhabrahimi", Banesa nr. 7, Tirane, shtetas shqiptar, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i leternjoftimit me nr. ID J60304043E.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 12

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen



të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 13

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 14

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues u gjet sipas vullnetit të tyre dhe u nënshkrua pa vërejtje.

Ky Akt-Themelimi hartohet në 2(dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES

Divinus Investments

FLORIAN ISMAILI



Ardit Sota

Ardit Sota

